




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO


KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-klina.org](http://www.komuna-klina.org)



## PROGRAMI TREVJEÇAR I BANIMIT 2022-2025



Nëntor, 2022

**LLOJI I DOKUMENTIT:**

**PROGRAMI KOMUNAL PËR BANIM 2022-2025**

**ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS**

**VENDIMI**

**KOMISIONI PËR HARTIMIN E PROGRAMIT TREVJEÇAR PËR BANIM:**

**GRUPI PUNUES -PËR HARTIMIN E PROGRAMIT TREVJEÇAR PËR BANIM**

| <b>Nr.</b> | <b>Emri dhe Mbiemri</b> | <b>Drejtoria</b> | <b>Përgjegjësia në Komision</b> |
|------------|-------------------------|------------------|---------------------------------|
| 1          | Ali Gashi               | DUMM             | Kryesues                        |
| 2          | Ilir Bacaj              | DSHMS / QPS      | Anëtar                          |
| 3          | Ahmet Berisha           | Administratë     | Anëtar                          |



|                                                                |    |
|----------------------------------------------------------------|----|
| Përmbajtja                                                     |    |
| HYRJE .....                                                    | 5  |
| QËLLIMI.....                                                   | 5  |
| OBJEKTIVI.....                                                 | 5  |
| KORNIZA LIGJORE .....                                          | 6  |
| DOKUMENTET TJERA RELEVANTE .....                               | 6  |
| STRATEGJITË E HARTUARA NË NIVELIN QEVERITAR .....              | 6  |
| ORGANOGRAMI I PËRPILIMIT TË PROGRAMIT TREVJEÇAR PËR BANIM..... | 7  |
| INFORMATAT SHITESË PËR HARTIMIN E PROGRAMIT .....              | 8  |
| PROFILI I KOMUNËS SË KLINËS.....                               | 8  |
| GJENDJA FAKTIKE .....                                          | 10 |
| POZITA GJEOGRAFIKE .....                                       | 10 |
| ANALIZË EKONOMIKE .....                                        | 12 |
| ANALIZË SOCIALE.....                                           | 12 |
| KARAKTERISTIKAT DEMOGRAFIKE.....                               | 13 |
| POPULLSIA .....                                                | 13 |
| VENDBANIMET .....                                              | 13 |
| BANIMI – FONDI BANESOR .....                                   | 13 |
| MIGRIMI.....                                                   | 15 |
| SHTIMI NATYROR .....                                           | 15 |
| JETËGJATËSIA .....                                             | 15 |
| TREGUESIT E ZHVILLIMIT NJERËZOR.....                           | 16 |
| ARSIMI .....                                                   | 16 |
| Punësimi .....                                                 | 18 |
| Papunësia.....                                                 | 18 |
| Gjendja Sociale.....                                           | 18 |
| AMBIENTI BIZNESOR .....                                        | 19 |
| TË ARDHURAT .....                                              | 19 |
| ANALIZË E GJENDJES EKZISTUESE TË BANIMIT SOCIAL .....          | 20 |
| ANALIZA E FAKTEVE.....                                         | 20 |
| OBJEKTET KOMUNALE TË DEDIKUARA PËR BANIM SOCIAL.....           | 21 |
| FAMILJET MOMENTALISHT TË NDIHMUARA ME BANIM SOCIAL .....       | 21 |

|                                                                                                          |    |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| KËRKESAT AKTUALE PËR BANIM SOCIAL .....                                                                  | 23 |
| KATEGORITË E SYNUARA .....                                                                               | 24 |
| KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E RADHËS SË PËRPARËSISË .....                                                   | 24 |
| GJENDJA FAKTIKE – ANALIZA NË FORMË TABELARE .....                                                        | 25 |
| KLASIFIKIMI I NEVOJAVE SIPAS URGJENCËS SË TRAJTIMIT TË TYRE .....                                        | 27 |
| PLANIFIKIMI KONKRET PËR NDIHMË PËR BANIM SOCIAL .....                                                    | 27 |
| O1. RISHQYRTIMI I STATUSIT TË FAMILJEVE TË VENDOSURA NË NDËRTESA PËR BANIM SOCIAL .....                  | 27 |
| O2.SIGURIMI I BANIMIT PËR 36 FAMILJE.....                                                                | 28 |
| Banesat e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe donatorët të cilat jepen me qira;.....                       | 28 |
| NDËRTIMI I OBJEKTIT BANESOR PËR DHËNIE ME QIRA JO PROFITABILË.....                                       | 28 |
| BONUS BANIMI .....                                                                                       | 31 |
| Banimi individual.....                                                                                   | 31 |
| RIVLERËSIMI I GJENDJES EKONOMIKE TË FAMILJEVE NË PËRPUTHJE ME UA, NR.18/2010 TË LIGJIT NR.03/L-164 ..... | 32 |
| ADMINISTRIMI DHE MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE NË BASHKËPRONËSI.....                                          | 32 |
| IMPLEMENTIMI I PROGRAMIT .....                                                                           | 33 |
| OBJEKTIVI 3 (O3) ÇAKTIMI I ZYRTARIT PËR BANIM .....                                                      | 33 |
| Ndarja e buxhetit për Banim Social.....                                                                  | 33 |
| Viti 2021.....                                                                                           | 33 |
| Viti 2022.....                                                                                           | 34 |
| Viti 2023.....                                                                                           | 34 |
| PËRPUTHJA E PROGRAMIT ME PLANET ZHVILLIMORE TË KOMUNËS.....                                              | 35 |
| INSTRUMENTET MBIQYRËSE.....                                                                              | 35 |
| INSTRUMENTET E GARANTIMIT TË REALIZIMIT TË PROGRAMEVE.....                                               | 36 |
| MASAT QË JANË MARRË PËR RESPEKTIMIN E KUADRIT LIGJOR .....                                               | 36 |
| PËRFSHIRJA E PUBLIKUT NË PROCESIN E SIGURIMIT TË TRANSPARENCËS .....                                     | 36 |
| PËRFUNDIM .....                                                                                          | 37 |
| ANALIZA SËOT .....                                                                                       | 38 |



## HYRJE

Komuna e Klinës me vendim të Kryetarit të Komunës, ka formuar Komisionin Komunal për hartimin e Programit Trevjeçar për periudhën 2022-2025. Me këtë akt, komuna e Klinës tregon përkushtim që të ndihmojë qytetarët e saj në nevojë për banim, përmes programeve të veçanta për banim të specifikuara në ligjet në fuqi.

E drejta për banim është njëra ndër të drejtat fundamentale të njeriut që garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Konventën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe me Kartën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Banimi është çështje vendimtare për një stabilitet social, shëndet të mirë dhe zhvillim kualitativ të mirëqenies sociale njerëzore. Banimi luan rol kryesor në krijimin e hapësirave ku njerëzit dëshirojnë të jetojnë, ku dëshirojnë të investojnë dhe të kalojnë jetën e tyre.

Republika e Kosovës është mbuluar mirë me legjislaturë për trajtimin e çështjes së banimit. Ligji bazë për këtë qëllim është Ligji për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit, Nr. 03/L-164, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr:03/L-040, të cilit i ofrohet baza ligjore për autoritetet vendimmarrëse lokale, duke ofruar banim të qëndrueshëm për popullatën në territorin e komunave të Republikës së Kosovës. Edhe komuna e Klinës në programet e saj zhvillimore ka për qëllim përmirësimin e banimit social për qytetarët e saj.

Programi Trevjeçar për Banim 2022-2025 do të mundësojë kushte për banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm për ato familje të cilat nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit dhe me forca vetanake e kanë vështirë të bëjnë një gjë të tillë.

## QËLLIMI

Qëllimi i këtij programi është krijimi i kushteve për banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm në harmoni me standardet dhe normat evropiane të banimit, me qëllim që të mundësohet zgjidhja e nevojave për banim, për grupe të caktuara të cilat nuk kanë forcë ekonomike që këtë problem ta zgjidhin sipas parimeve të tregut.

## OBJEKTIVI

Objektiv i gjithmbarshëm i komunës së Klinës është që përmes këtij programi të bëjë përmirësimin e vazhdueshëm të nivelit të jetesës në përgjithësi, që rezulton në reduktimin e numrit të familjeve që kanë nevojë për mbështetje në fushën e banimit.

Në këtë program do të prezantohen indikatorët si në vijim:

- ✓ Prezantimi i kapaciteteve reale të komunës së Klinës në fushën e banimit;
- ✓ Përcaktimi i numrit të familjeve të cilat duhet të ndihmohen nga komuna me banim në periudhën trevjeçare;
- ✓ Identifikimi i programeve të veçanta për banim si mekanizëm për të ndihmuar familjet e identifikuar në nevojë për banim, dhe

- ✓ Gjetjen e mënyrave të financimit për realizimin e zbatimit të Programit Trevjeçar të Banimit.

## **KORNIZA LIGJORE**

Programi Trevjeçar për Banim është bazuar në legjislaturën si në vijim:

- Ligji Nr. 03/L-164, dt.04.2010 për Financimin e programeve të veçanta të banimit;
- Udhëzimi Administrativ për përmbajtjen e Kontratës për banesën me qira jo profitabile, Nr.10/2010 dt.2.09.2010;
- Udhëzimi Administrativ për përmbajtjen e bonusit të banimit, Nr.19/2010-dt.02.09.2010;
- Udhëzimi Administrativ për procedurat e përfitimit nga programet e veçanta të banimit, Nr.22/2010, dt.18.11.2010;
- Udhëzimi Administrativ për normat e banimit për programet e veçanta të banimit, Nr.24/2010, dt.18.11.2010;
- Udhëzimi Administrativ për procedurat e shpalljes të programeve të veçanta të banimit, Nr.23/2010, dt.18.11.2010;
- Udhëzimi Administrativ për përcaktimin e radhës së përparësisë për kategoritë e familjeve që mund të përfitojnë nga programet e veçanta të banimit, Nr.21/2010, dt. 18.11.2010;
- Ligji 04/L-134 të ndërtësës në bashkëpronësi, dt.06.09.2013;
- Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dt.19.06.2008;
- Ligji nr.04/L-061 për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, dt.27.01.2012;
- Udhëzuesi për hartimin e programeve komunale trevjeçare të banimit;
- Statuti i Komunës;
- Dokumentet planore - urbane;
- Ligji për Procedurat Administrative, 05/L-031, dt.21.06.2017.

## **DOKUMENTET TJERA RELEVANTE**

- Udhëzuesi për hartimin e programeve komunale trevjeçare të banimit,
- Statuti i Komunës;
- Plani Zhvillimor Komunal;
- Plani Rregullues i hollësishëm;
- Harta Zonale e Klinës

## **STRATEGJITË E HARTUARA NË NIVELIN QEVERTAR**

- Strategjia dhe plani i veprimit për përfshirjen e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë në shoqërinë Kosovare, 2016-2020; Plani i veprimit i komunës së Klinës për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptianë.



- Strategjia Kombëtare për Ri integrimin e Personave të Riatdhesuar 2018-2022, Plani i Veprimit dhe Rregullorja nr.13/2017 për ri integrim të personave të riatdhesuar, procedurat dhe kriteret e përfitimit për ri integrimin e personave të riatdhesuar;
- Strategjia për Komunitete dhe Kthim 2014-2018 dhe Plani i veprimit për strategjinë për komunitet dhe kthim 2014 - 2018;
- Strategjia e zhvillimit ekonomik e Komunës së Klinës 2022-2027;

## ORGANOGRAMI I PËRPILIMIT TË PROGRAMIT TREVJEÇAR PËR BANIM

Procesi i hartimit të programit trevjeçar për banim është bërë me pjesëmarrjen e shumë akterëve nga drejtori të ndryshme komunale sipas organogramit në vijim:



Tabela 1. Procesi i përpilimit të programit trevjeçar për banim

## **INFORMATAT SHITESË PËR HARTIMIN E PROGRAMIT**

Për përpilimin e programit trevjeçar të banimit, vendimet shitesë për përpilim të Programit Trevjeçar për Banim janë si në vijim:

- Vendimi i Kryetarit të Komunës së Klinës për përgatitjen e Projektit të Programit të Veçantë për Banim në Komunën e Klinës, për periudhën 2022-2025;
- Sigurimi i të dhënave nga fushat përkatëse të Komunës (Drejtoria e Arsimit, Qendra për Punë Sociale, Zyra për Komunitete, Qendra për Punësim);
- Identifikimi i grupeve të synuara në nevojë për banim duke i përfshirë edhe komunitetet të cilat jetojnë në Klinë;
- Kategorizimi i grupeve dhe klasifikimi i kërkesave për përcaktimin e radhës së përparësisë(UA Nr.21/2010) për gjendjen faktike të çështjes së banimit;
- Struktura e Buxhetit Komunal në Klinë;
- Përgatitja e dokumentit;
- Bërja publike e programit trevjeçar të banimit (informimi);
- Prezantimi i draftit të qytetarët e Klinës (Dëgjimi publik)
- Procedurat e miratimit të dokumentit;
- Aprovimi nga Kuvendi i Komunës;
- Kërkimi i ligjshmërisë së dokumentit nga ministria e linjës;

## **PROFILI I KOMUNËS SË KLINËS**

Në shekullin e parë të erës së re, territori i Klinës si dhe i gjithë Dardanisë gjendej nën sundimin e Perandorisë Romake në ç'kohë në afërsi të Klinës përmendet Dresniku si qendër komunale e fafesisit Dardan. Pas rënies së Perandorisë Romake, Dardania, pra edhe Klina me rrethinë, u vërshua nga sllavët, e cila dyndje në gadishullin Ballkanik mori fund në shek. VIII.

Profirogoniti në traktin e tij të njohur "Shënime për popujt" shkruan në vitin 948-952, se ndër qytetet e banuara dendur është edhe Dresniku - "Desstinik". Vendbanim i hershëm është edhe Dollci i sotëm, i cili ishte i shënuar me emrin Zalug në hartën e Manastirit të Hilandarit në vitin 1200 nga Solovjevi. Pas rënies nën sundimin turk, jeta e shqiptarëve ishte e vështirë. Prej atëherë Klinën e karakterizon edhe larmia fetare. Popullsia e këtyre trevave merrej kryesisht me bujqësi e cila ishte mjaft e zhvilluar.

Klina identifikohet si vendbanim i hershëm Ilir, me emër Chinna, të cilën e hasim te Ptolomeu që në vitet 87-150 (në hartën e Ptolomeut). Ky lokalitet i lashtë ilir shtrihej në bregun e majtë të



rrjedhës së epërme të Drinit të Bardhë, që i përgjigjet realitetit të sotëm gjeografik. Kjo datë si dhe Ujëvara e Mirushës u bënë edhe simbol i Emblems së qytetit të Klinës. Chinna në kuptimin Cin shpjegohet si kin në mes të Drinit të Bardhë dhe lumit Klina. Banorët e këtyre viseve nuk pushuan së luftuari për liri deri në ditët e sotme.

## GJENDJA FAKTIKE

### POZITA GJEOGRAFIKE

Komuna e Klinës, shtrihet në anën perëndimore të Kosovës, përkatësisht në pjesën verilindore të Rrafshit të Dukagjinit, në një hapësirë të pasur me potenciale natyrore dhe me lidhje të mira qarkullimi. Kufizohet me shtatë komuna: Në veri kufizohet me Istogun, në lindje me Skenderajn dhe Drenasin, në jug kufizohet me Malishevën, Rahovecin dhe Gjakovën, ndërsa në perëndim me Pejën. Nëpër territorin e Klinës kalojnë pesë lumenj: Drini i Bardhë, lumi i Pejës, lumi Klina, Mirusha, si dhe lumi i Istogut. Pozita gjeografike dhe kushtet klimatike janë të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë: kultivimit të kulturave bujqësore, perimeve, pemëve, si dhe zhvillimin e blegtorisë, shpeztarisë, dhe bletarisë.

Komuna e Klinës përfshin një sipërfaqe prej 308.8 kilometra katrorë. Ndahet në 14 bashkësi lokale me gjithsej 54 vendbanime.

| POPULLSIA |                                              |                                               |
|-----------|----------------------------------------------|-----------------------------------------------|
| 1         | Dendësia                                     | 178.1 ban/km <sup>2</sup>                     |
| 2         | Mosha 0-24 vjeç (kryesisht % e moshës së re) | 62.4%                                         |
| 3         | Familja mesatare                             | 5 anëtarë                                     |
| 4         | Nataliteti                                   | Rreth 13% në vit                              |
| 5         | Arsimimi                                     | Arsimimi tek të rriturit në %                 |
|           |                                              | Meshkuj 97.54      Femra 91.47                |
| 6         | Migrimi                                      | 18.7% e popullsisë jetojnë në botën e jashtme |
| 7         | Ekonomitë familjare dhe                      | 7540                                          |
| 8         | Banesat                                      | 1065, banim shumë banesorë                    |
| 9         | Situata ekonomike                            | Rreth 1000 biznese të vogla dhe të mesme      |



**MBULUESHMËRIA ME PLANE**

|   |                                                              |                     |
|---|--------------------------------------------------------------|---------------------|
| 1 | Sipërfaqja e përgjithshme e Komunës e përfshirë në PZHK+HZK  | 309 km <sup>2</sup> |
| 2 | Sipërfaqja e përgjithshme e Komunës e përfshirë në PZHU+PRRH | 439.58 h            |
| 3 | Mbulueshmeria me Plane rregulluese                           | 439.58 h            |
| 4 | Numri i vendbanimeve joformale në Komunë                     | 7.00                |

**SHFRYTËZIMI I TOKËS**

|   |                                           |                       |
|---|-------------------------------------------|-----------------------|
| 1 | Sipërfaqja e tokës ndërtimore             | 439.58 /ha urban      |
| 2 | Sipërfaqja e planifikuar - tokë bujqësore | 14.000 ha             |
| 3 | Sipërfaqja totale e banimit               | 955.430m <sup>2</sup> |
| 4 | Sipërfaqja e banimit të planifikuar       | 439.58 ha             |

**FONDI BANESOR**

|   |                                                                       |                                                                      |
|---|-----------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------|
| 1 | Nr. i objekteve të banimit                                            | 1759 njësi të banimit në qytetin e Klinës                            |
| 2 | Nr. i banesave në pronësi komunale (në kuadër të objekteve kolektive) | 23+23+25+35-njësi banesore-Katër objekte, Gjithsejtë - 106njesi-ban. |
| 3 | Me partneritet publik privat (përfitues janë ish banorët)             | 8 objekte banesore,                                                  |
| 4 | Qendra për banim social                                               | 4 objekte banimi                                                     |
| 5 | QPK (Qendra të përkohshme kolektive)                                  | /                                                                    |



## ANALIZË EKONOMIKE

Komuna e Klinës, që nga paslufta ka bërë përparime në aspektin e zhvillimit ekonomik. Ekonomia e Klinës është e bazuar në veprimtari bujqësore dhe përpunimit të prodhimeve bujqësore. Disa ndërmarrje industriale bujqësore të periudhës së paraluftës, tanimë nuk punojnë dhe së shpejti do t'i nënshtrohen privatizimit. Kombinati bujqësor "Malishgan" para luftës i ka punësuar afër 1,500 punëtorë, kurse tani ka të punësuar vetëm disa dhjetëra. Ndërsa, në rrafshin industrial, Klina posedon resurse të boksitit dhe të thëngjillit. Klina është po ashtu e pasur edhe me zona të njohura të eksploatimit të rërës dhe zhavorrit si dhe gurëve mjaft cilësor për ndërtimtari.

Pasuritë natyrore të Klinës janë parakusht themelor për zhvillimin e turizmit dhe për zhvillimin e veprimtarive për promovimin e vlerave të shumta etnokulturore si dhe trashëgimisë. Klina në mesin e pasurisë së saj, ka bukurinë e rrallë natyrore e që përbëhet nga Ujëvarat e Mirushës, të cilat ofrojnë mundësi të mëdha për zhvillimin e turizmit.

Shumica e aktiviteteve të banorëve është në veprimtaritë shërbyese hoteliere dhe zejtare, e cila në shumicën e rasteve zhvillohet në kuadër të objekteve të banimit.

Ekonomia e Klinës, tani është e bazuar në ndërmarrje të mesme dhe të vogla. Në Klinë tashmë operojnë rreth 1000 biznese të vogla dhe të mesme. Prej këtyre si më të suksesshme konsiderohen të jenë: "Citadela", "Benita Company", "Gllareva", "Semirra", "Mirusha Company" Agro-Elita etj., të cilat në masë të madhe kanë ndikuar në zbutjen e papunësisë, ngase në këto ndërmarrje punojnë shumë punëtorë, të cilët me pagat e tyre ndihmojnë në zhvillimin e ekonomive të tyre familjare.

## ANALIZË SOCIALE

Në Komunën e Klinës, raste sociale të përfshira në skemën e asistencës sociale janë: 848 familje, me 3445 anëtarë, ky numër ndryshon nga muaji në muaj. Një numër i konsiderueshëm i tyre jetojnë në kushte jo të mira të banimit dhe kanë nevojë për përmirësimin e kushteve të jetesës së tyre.

- Me asistencë sociale, nevoja: numri i familjeve shfrytëzuese të asistencës sociale është 848 (marrë nga Raporti mujor financiar-ndihma sociale). Numri i përfituesve, ndryshon çdo muaj, varësisht nga kërkesat. Numri i kërkesave në muajt e fundit është rritur, për shkak të gjendjes së renduar ekonomike në familje.
- Prej vitit 2004 deri në vitin 2018 janë ndërtuar 4 objekt për banim sociale, 2006-23, 2010-25, dhe 2018-35 njësi banesore.
- Minoritetet: Nga lista e vitit 2021-2022 janë paraqitur 230 kërkesa për kthim dhe zgjidhjen e çështjes së banimit, ndërsa janë ndërtuar 13 shtëpi.



Të punësuarit nga buxheti shtetëror: Në përgjithësi në Komunën e Klinës janë 904 persona të punësuar në sektorin publik dhe rreth 2.000 të punësuar në atë privat, shumica prej tyre në qytetin e Klinës.

## **KARAKTERISTIKAT DEMOGRAFIKE**

### **POPULLSIA**

Në Komunën e Klinës jetojnë rreth 38.200 banorë. Në qytetin e Klinës jetojnë 8.700 banorë, ndërsa 29.500 jetojnë në zonat rurale. Në vitin 2003, sipas vlerësimeve dendësia në Komunën e Klinës kishte rreth 178.1 banor/km<sup>2</sup>, që është më e ulët se mesatarja e Kosovës për rreth 48 banorë/km<sup>2</sup>.

### **VENDBANIMET**

Rrjetin e vendbanimeve në Komunën e Klinës e përbëjnë: qendra komunale Klina, qendrat lokale, fshatrat, lagjet dhe grupet e shtëpive. Vlen të theksohet se nga pikëpamja hapësinore numri më i madh i vendbanimeve është përqendruar në viset fushore, rrëzë maleve e kodrave. Tipi i vendbanimeve është kryesisht vendbanim i tipit të grumbulluar kryesisht fushore, por edhe kodrinore - malore dhe tipit të ndarë në lagje.

Qyteti i Klinës shtrihet përgjatë anës së majtë të lumit Drini i Bardhë, pranë derdhjes së lumit Klina. Lumenjtë Drini i Bardhë dhe Klina, si dhe kodrina në veri të qytetit, krijojnë një trekëndësh brenda të cilit qyteti është zhvilluar derisa tri drejtimet kryesore rrugore (Klinë - magjistrale, Klinë - Istog dhe Klinë- Skenderaj), paraqesin boshtet përgjatë të cilave qyteti zgjerohet.

Pas krijimit të Komunës së Klinës, qyteti i Klinës fitoi rolin e qendrës komunale, gjë që ndikoi në përqendrimin e funksioneve publike, administrative dhe ekonomike të rëndësishme për Komunën dhe si rezultat u ndikua edhe fizionomia e Klinës si vendbanim. Në pjesën verilindore, në dalje të qytetit në drejtim të Skenderajt, shtrihet zona industriale e cila ka lidhje të mira komunikacioni hekurudhor dhe rrugor.

Sipas PU, banimi është zhvillimi përgjatë tri drejtimeve kryesore rrugore dhe i definon konturat e jashtme të qytetit. Lagjet e banimit pothuajse në tërësi përbëhen prej banimit individual, ndërsa në shumë pjesë lagjet nuk janë të urbanizuara dhe ka mangësi në vendosjen racionale të shtëpive, shfrytëzimin dhe trajtimin e sipërfaqeve të tokë, në infrastrukturë etj. Dendësia e banimit është 36.25 banorë/ha, që është një dendësi relativisht e ulët duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me zonë urbane.

### **BANIMI – FONDI BANESOR**

Në qytetin e Klinës dominon banimi i ulët, i cili në pjesën më të madhe përbëhet prej shtëpive individuale. Si shkas i banimit të ulët individual qyteti pasqyrohet me një dendësi të ulët të banimit prej 36.25 banorë/ha.



Nga 1759 njësi të banimit në qytetin e Klinës, 280 apo 16% përbëhet nga banimi shumëbanesorë, ndërsa edhe vetë fondi banesorë është i shpërndarë në 30 seksione të cilat janë të ndërtuara në qendrën e ngushtë të qytetit si dhe përgjatë tri rrugëve kryesore që çojnë në drejtim të Istogut, Skenderajt dhe në drejtim të magjistrale Prishtinë-Pejë. Periudha e ndërtimit të ndërtesave shumëbanesore përfshijnë vitet '50 deri në vitet '90. Në shumicën e këtyre ndërtesave etazhiteti është P+4, kurse numri banesave në kat sillet prej 2 deri në 4. Një pjesë e këtyre ndërtesave, sidomos ato më të vjetrat, kanë nevojë për intervenime në izolime, instalime, sistemin e largimit të ujërave atmosferike dhe elemente të fasadës. Furnizimi me ujë në këto ndërtesa bëhet përmes ujësjellësit derisa rreth 25% të familjeve ankohen në furnizim të pamjaftueshëm me ujë. Sistemi i ngrohjes qendrore nuk ekziston, ndërsa rreth 85% të familjeve për ngrohje shfrytëzojnë lëndën e drurit si dhe atë të thëngjillit.

Banimi individual përbën 84% të fondit të përgjithshëm të banimit në qytetin e Klinës, ndërsa numri i shtëpive është 1,479.

Pjesa më e madhe e shtëpive në qytetin e Klinës janë ndërtuar pas viteve '40, shtëpitë e ndërtuara gjatë periudhës së viteve '50-'70 kanë përfshirë hapësirën përgjatë tri ndërtimeve kryesore rrugore duke i dhënë konturat që qyteti ka sot. Gjatë viteve '80-'90, ndërtimi i shtëpive ka plotësuar dhe zgjeruar kufijtë e qytetit përgjatë këtyre tri boshteve të zhvillimit.

Pas luftës në qytetin e Klinës janë ndërtuar rreth 100 shtëpi dhe atë kryesisht brenda kufijve ekzistues të qytetit duke i plotësuar hapësirat e lira apo duke u ngritur në themelet e shtëpive të shkatërruara gjatë luftës. Sipas gjendjes fizike 45% e shtëpive janë në gjendje të mirë, 12% janë në gjendje relativisht të mirë, 8% janë në gjendje të dobët, 26% janë ende të papërfunduara, ndërsa rreth 8% janë ende të shkatërruara.

Pjesa dërmuese e shtëpive janë të ndërtuara me etazhitet P+1 dhe P+2. Shtëpitë që gjenden pranë rrugëve kryesore dhe më të frekuentuara të qytetit (sidomos ato përreth sheshit "Mujë Krasniqi", në rrugën Klinë-Istog, Klinë-magjistrale, qendër-shkolla e mesme), kanë përdhese aktive ku dominojnë përmbajtjet tregtare, hoteliere dhe shërbyese.

Vlen të theksohet se furnizimi i lagjeve të banimit individual me infrastrukturë dhe shërbime ka nevojë për plotësime, megjithatë: 86.1% e shtëpive furnizohen me ujë nga ujësjellësi, ndërsa shumica e qytetarëve pohojnë se këtë ujë nuk mund të shfrytëzohet për pije, 42.8% e shtëpive furnizohen me ujë nga puset, ndërsa 5.2% furnizohen edhe në mënyra tjera, 68.3% e shtëpive kanë kycje në rrjetin e kanalizimit të qytetit, 19.3% e ujërave të zeza i zbrazin në gropa septike, 6.4% në lumë dhe 6% në forma të tjera. Janë rreth 98% e ekonomive familjare që shfrytëzojnë për ngrohje lëndën e drurit apo thëngjillin.



## MIGRIMI

Problemi i njëjtë si në gjithë Kosovën qëndron edhe me Komunën e Klinës, ku kemi emigrime dhe migrime të shumta, por asnjëherë nuk mund të japim shifrat e sakta se sa është numri i qytetarëve tanë që jetojnë punojnë dhe veprojnë jashtë territorit të Komunës, sidomos atyre që jetojnë jashtë Kosovës.

Sipas të dhënave paraprake nga regjistrimi i fundit (2011), nga ESK Komuna e Klinës ka 38200, ku 11200 jetojnë në diasporë.

Qyteti i Klinës, si qendër komunale është karakterizuar me migrim të popullatës në të. Sipas të dhënave nga hulumtimi në terren 61.5% të familjeve jetojnë në këtë qytet para vitit 1990, 6% të familjeve janë vendosur në Klinë gjatë periudhës 1990-1999, ndërsa pas luftës së vitit 1999 në Klinë janë vendosur 32.6% të familjeve. Si arsye kryesore për migrim në Klinë janë cekur arsyet sociale, shkollimi dhe infrastruktura

## SHTIMI NATYROR

Burime spitalore dhe burime tjera tregojnë se lindjet e periudhës 1990 deri 2010 tregojnë se numri i lindjeve në Kosovë është në rënie të vazhdueshme. Kjo rënie e lindshmërisë është si pasojë e rënies së vazhdueshme ekonomike dhe rritjes së varfërisë dhe pasigurisë në prosperitet dhe zhvillim ekonomik.<sup>1</sup>

Edhe pse pothuajse të gjithë treguesit e shtimit të popullsisë kanë shënuar rënie gjatë viteve të fundit, popullata e Kosovës ende mbetet njëra ndër popullatat me shtim më të lartë në rajon, por edhe më gjerë. Ky është rezultat i zvogëlimit të ngadalshëm të shkallës së natalitetit dhe i zvogëlimit rapid të shkallës së mortalitetit. Shkalla e shtimit natyror është rreth 13% në vit.

## JETËGJATËSIA

Është e njohur teoria se popullsia e varfër nuk jeton gjatë, kjo nuk mund të përjashtojë as banorët e Komunës së Klinës. Statistikat tregojnë se popullsia kosovare jeton mesatarisht diku rreth 69 vite, diku afërsisht jetëgjatësia e popullsisë është e njëjtë edhe në Klinë me atë të jetëgjatësisë në Kosovë.

Mendojmë<sup>2</sup> se niveli i zhvillimit nuk mund të matet vetëm në bazë të të ardhurave, por duhet të merren parasysh edhe disa tregues të zhvillimit si: jetëgjatësia, arsimimi-shkalla e arsimimit të të rriturve, regjistrim në shkolla, të ardhurat për kapital etj.

- Jetëgjatësia, është një prej treguesve të rëndësishëm, kjo ka të bëjë me jetën e njerëzve, sa dhe si i përdorin burimet financiare në të mirë të përmirësimit të kushteve shëndetësore, ushqimit dhe standardit të jetës, nga këto të dhëna llogaritet treguesi i jetëgjatësisë.

<sup>1</sup> Plani Zhvillimor i Komunës së Klinës 2015-2021, janar 2013, f. 20.

<sup>2</sup> Nga Raporti I Zhvillimit Njerëzor-Kosova 2004.

- Zhdukja e analfabetizmit dhe niveli i shkollimit, të shprehura me përqindjen e popullsisë që nuk di shkrim lexim dhe me mesataren e viteve të shkollimit për ata që mësojnë në shkollë, kjo na ndihmon në llogaritjen e koeficientit të shkollimit, apo treguesit të arsimimit.
- Prodhimi i brendshëm bruto, pasqyron të ardhurat mesatare për kapital, të llogaritura për fuqi blerëse, kjo na mundëson llogaritjen e treguesve të të ardhurave.

#### TREGUESIT E ZHVILLIMIT NJERËZOR

Në vijim janë të prezantuar disa indikator të zhvillimit njerëzor në Komunën e Klinës

| Komuna                                            | Prishtina | Klina  | Kosova |
|---------------------------------------------------|-----------|--------|--------|
| Jetëgjatësia prej lindjes                         | 71        | 68.10  | 69     |
| Shkalla e arsimimit të të rriturve (15+)          | 96        | 94.46  | 94     |
| Shkalla e kombinuar e regjistrimit në shkolla (%) | 91        | 83.94  | 88     |
| Të ardhurat për kokë të banorit në Euro           | 1586      | 919.18 | 1053   |
| Treguesi i jetëgjatësisë                          | 0.77      | 0.718  | 0.73   |
| Treguesi i arsimimit                              | 0.94      | 0.91   | 0.92   |
| Treguesi i të ardhurave                           | 0.46      | 0.370  | 0.39   |
| Treg. I zhvill. Njerëzor                          | 0.72      | 0.666  | 0.68   |

Tabela 1. Indikatorët e zhvillimit njerëzor

#### ARSIMI

Përqindja e arsimimit të njerëzve 15 vjeçar e përmbi- Klinë:

| Komuna e Klinës |                          |                 |
|-----------------|--------------------------|-----------------|
| Nr.             | Shkalla e arsimimit në % | Nr. i përgjith. |
| 1               | Pa arsimim               | 0.55            |



|          |                                   |       |
|----------|-----------------------------------|-------|
| 2        | Më pak se fillore(1-3)vite        | 2.03  |
| 3        | Më pak se fillor (4-7) vite       | 15.29 |
| 4        | Shkollë fillore                   | 34.07 |
| 5        | Më pak se shkollë të mesme (9-10) | 8.66  |
| 6        | Shkollë të mesme (11-12)          | 31.86 |
| 7        | Shkollë të lartë                  | 6.63  |
| 8        | Universitet e më lart             | 0.92  |
| Gjithsej |                                   | 100   |

:

|       | Shkalla e regjistrimit % |       |        |       |          |       |       |       |           |      |
|-------|--------------------------|-------|--------|-------|----------|-------|-------|-------|-----------|------|
|       | Shkalla e arsimimit      |       | Fillor |       | Të mesme |       |       |       | Mesatarja |      |
|       | Meshkuj                  | Femra | M      | F     | M        | F     | M     | F     | M         | F    |
| Klinë | 97.54                    | 91.47 | 96.51  | 97.37 | 71.79    | 50.00 | 88.80 | 78.86 | 9.81      | 7.78 |
| Rural | 97.03                    | 90.97 | 95.61  | 95.94 | 75.24    | 66.13 | 88.71 | 85.69 | 10.00     | 7.94 |
| Urban | 97.54                    | 91.74 | 94.03  | 95.98 | 83.38    | 78.39 | 90.54 | 89.70 | 10.88     | 8.99 |

Tabela 2:Shkalla e arsimimit, shkalla e regjistrimit dhe mesatarja e viteve të shkollimit sipas gjinisë

**Burimi:** Të dhënat nga Tabela 4,5 dhe 6 janë bazuar nga "Plani Zhvillimor i Komunës së Klinës 2011-2021", "Profili Urban i Klinës", i hartuar në 2004-2005, si dhe nga "Raporti i zhvillimit Njerëzor-Kosova 2004"- UNDP.

Treguesi i zhvillimit njerëzor është një kombinim i treguesit të jetëgjatësisë, treguesit të arsimimit dhe treguesit të të ardhurave. Kjo llogaritje për herë të parë është aplikuar në Kosovë nga UNDP,

në vitin 2004, ku ka dalë se Kosova ka treguesin e zhvillimit njerëzor në koeficientin prej 0.68, ku janë marrë parasysh treguesi i jetëgjatësisë prej 0.73, treguesi i arsimimit prej 0.92 dhe treguesi i të ardhurave prej 0.39. dhe nga këta koeficient ka rezultuar se Kosova renditet në mesataren e vendeve me zhvillim mesatar njerëzor.

#### Punësimi

Ka të punësuar në sektorin publik 941 punëtorë, në sektorin privat rreth 2000 punëtorë, kurse të evidentuar në Zyrën për punësim janë gjithsej 5,189 të lajmëruar, prej tyre 2,053 femra; 97 prej tyre me fakultet 41 femra. Duke iu referuar këtyre të dhënave del se prej numrit të punësuarve të regjistruar janë me shkollë të mesme. Vlerësohet se edhe në komunën e Klinës papunësia sillet në mesataren e vendit prej rreth 35%.

#### Papunësia

Tregu i të papunëve në Kosovë është shumë i lartë, ka shifra që tregojnë se 35% e popullsisë së aftë për punë nuk punon dhe nuk realizon asnjë të ardhur për veten dhe familjen e tij.

Të papunësuar në Komunën e Klinës janë gjithsej 35% të lajmëruar në entin për punësim janë:

|          |         |       |
|----------|---------|-------|
| 1.       | Meshkuj | 3136  |
| 2.       | Femra   | 2.053 |
| Gjithsej |         | 5.189 |

Tabela 3: Numri i të papunëve në komunën e Klinës

#### Gjendja Sociale

| Nr | Kualifikimi           | Nr. i përgjith. | Femra | Meshkuj |
|----|-----------------------|-----------------|-------|---------|
| 1  | Të pa kualifikuar     | 3063            | 1498  | 1565    |
| 2  | Gjysmë të kualifikuar | 588             | 354   | 234     |
| 3  | Të kualifikuar        | 175             | 17    | 158     |
| 4  | Shkollë të mesme      | 1874            | 373   | 1501    |
| 5  | Shkollë të lartë      | 37              | 12    | 25      |



|   |           |      |      |      |
|---|-----------|------|------|------|
| 6 | Fakultet  | 11   | 1    | 10   |
|   | Gjithsej: | 5748 | 2255 | 3493 |

| Nr. i familjeve përfituese të asistencës sociale |           |             |
|--------------------------------------------------|-----------|-------------|
| Periudha                                         | Familje   | Anëtarë     |
| 2018/2019                                        | 828 - 790 | 3414/3263   |
| 2019/2020                                        | 790 - 814 | 3414/3359   |
| 2020/2021                                        | 814 - 882 | 3359 - 3650 |
| 2021/2022                                        | 882 - 921 | 3650 - 3802 |
| 2022 - nëntor, 2022                              | 921 - 848 | 3802 - 3445 |

Tabela 4: Indikatorët e gjendjes sociale

#### AMBIENTI BIZNESOR

Resurset ekonomike dhe burimet njerëzore të Klinës janë shumë të favorshme për një zhvillim të qëndrueshëm dhe prosperitet ekonomik në shumë lëmenj, sidomos në bujqësi dhe minerale. Në Komunën e Klinës veprojnë rreth 1000 biznese.

Nga bizneset e regjistruara, shumica prej tyre kanë 1-3 punëtorë, pastaj ato të mesme të cilat kanë nga 10-100 punëtorë, numri i tyre është i vogël.

Vlen të theksohet se Klina është e pasur me pasuri natyrore, ka pozitë të mirë për zhvillimin e bujqësisë, tokë pjellore ku gravitojnë gjashtë lumenjtë të cilët mund të shfrytëzohen për ujitjen e kulturave bujqësore. Në sferën industriale, Klina posedon me pasuri të boksitit dhe thëngjillit, e pasur po ashtu është edhe me zona të njohura për eksploatimin e rërës, të zhavorrit dhe të gurëve mjaft cilësor për ndërtimtari. Potenciale për zhvillim të turizmit në Klinë, po ashtu ekzistojnë, me këtë rast theksi mund të vihet sidomos tek: "Ujëvarat e Mirushës", Klina po ashtu posedon me vlera etnokulturore, arkeologjike dhe të trashëgimisë të cilat mund të shfrytëzohen për krijimin e një ambienti biznesor, të favorshëm dhe për zhvillim ekonomik.

#### TË ARDHURAT

Sipas disa llogaritjeve të përafërta dhe empirike, të ardhurat për kokë banori në komunën e Klinës janë rreth 252 € në muaj, vlerë kjo e cila është pak më e lartë se mesatarja e të ardhurave mujore



për kokë banori në Kosovë, e cila duhet të sillet diku rreth 250 € në muaj. Edhe pse Klina ka një pozicion të favorshëm ku vlen të ceket se është nyje e dytë hekurudhore, ka Minierën e Boksitit, si dhe pjesa me e madhe e tokës ka mundësi të ujitet falë lumenjve të shumtë që gjenden në territorin e Klinës, megjithatë duhet punuar dhe ndikuar që zhvillimi i sektorit privat, agrobiznesit dhe zhvillimit të bujqësisë t'i kushtohet vëmendje dhe prioritet në politikat zhvillimore.

## **ANALIZË E GJENDJES EKZISTUESE TË BANIMIT SOCIAL**

Në vijim do të prezantohet gjendja aktuale lidhur me objektet në pronësi të komunës të dedikuara për banim social si dhe numri/profili i familjeve tani më të ndihmuara me sigurim të banimit. Po ashtu do të prezantohet kërkesa aktuale për banim në komunën e Klinës.

### **ANALIZA E FAKTEVE**

Në Komunën e Klinës investimet në sektorin e banimit kanë filluar menjëherë pas çlirimit gjegjësisht pas konstituimit të Komunës. Investimet në ekonominë e Klinës përfshinin ndërtimin e infrastrukturës dhe krijimin e kushteve për jetë më të mirë. Këto investime mund t'i klasifikojmë në dy faza: Faza e parë, kishte të bënte me periudhën emergjente ose krijimin e kushteve për banimin e qytetarëve të mbijetuar e që ju ishin shkatërruar ekonomitë familjare. Ndërsa, faza e dytë përfshin periudhën e investimeve kapitale ose krijimin e kushteve për jetë më të mirë për një infrastrukturë më të zhvilluar dhe përpjekjet për zhvillimin e ekonomisë së mirëfilltë për të gjithë qytetarët e Klinës.

Në fazën e parë, faktor vendimtar kanë qenë donatorët e ndryshëm kryesisht ndërkombëtar, të cilët mjetet e tyre i orientuan kryesisht për ringritjen e ekonomive familjare në sektorin e banimit. Ndër organizata të shumta ndërkombëtare që investuan në Komunën e Klinës mund të përmendim UNDP, DRC, MERCY CORPS, Caritas Svitzerland etj.

Pas konstituimit të organeve vendore si ato lokale po ashtu edhe qendrore orientimi i mjeteve bëhet në përmirësimin e kushteve të jetës për banorët e Komunës së Klinës. Kështu, nëse kategorizojmë investimet varësisht nga prejardhja e mjeteve buxhetore, përfshijmë tri kategori: investimet nga mjetet buxhetore, investimet nga donatorët, si dhe ato me pjesëmarrjen e qytetarëve.

Investimet nga donatorët janë më të shumta sipas vlerës dhe marrin pjesë me 56.30%, ndërsa nga programet e realizuara përfshijnë kryesisht ato emergjente. Përfitues në ndërtimin e shtëpive nga donatorët në periudhën emergjente ishin 1288 familje 2000-2009.

Në vitin 2006-2009, në Komunën e Klinës është implementuar Programi për Kthim të Qëndrueshëm, nga ky program në bashkëveprim me Komunën janë implementuar 6 projekte: Pogradja, Klinaci 1 dhe 2, Bërkova 1 dhe 2, si dhe Rudica dhe Dollci, vlera e projektit përafërsisht ka kushtuar 1,350,000.00. Duhet cekur se në këtë fazë përfitues janë kryesisht pjesëtarë të komunitetit serb që kanë shprehur dëshirën për kthim, ndërsa në tërësi nga këto projekte kanë



përfitur **224 familje** në ndërtimin e shtëpive të banimit, mjete këto të donatorëve, MKK, si dhe Komuna e Klinës.

Jo vetëm pjesëtarët e komunitetit shumicë apo edhe atij serb rezultojnë të kenë përfitur nga donacionet dhe mjetet buxhetore lokale dhe qendrore, por edhe pjesëtarët e tjerë të minoriteteve, siç janë minoriteti rom, ashkali dhe egjiptas. Për këto komunitete janë ndërtuar rreth 118 objekte të banimit individual, si në qytetin po ashtu edhe në fshatrat e Klinës.

Për të bërë më të qartë dhe më të lehtë kuptimin e fakteve të përshkruara deri më tani, ne kemi ndarë analizën e fakteve të paraqitura në dy pjesë: si analizë ekonomike dhe si analizë sociale.

#### OBJEKTET KOMUNALE TË DEDIKUARA PËR BANIM SOCIAL

Në komunën e Klinës janë ndërtuar 4 objekte banesore me qëllim të zbutjes së banimit për familjet që kanë nevoja për strehim.

|   |            |                     |     |                   |
|---|------------|---------------------|-----|-------------------|
| 1 | Banesa I   | 2005-MMPH           | P+4 | 23 njësi banesore |
| 2 | Banesa II  | 2006-donator i huaj | P+4 | 23-njësi banesore |
| 3 | Banesa III | 2010-MPMS           | P+4 | 25-njësi banesore |
| 4 | Banesa IV  | 2018 MPMS           | P+6 | 35-njësi banesore |

#### FAMILJET MOMENTALISHT TË NDIHMUARA ME BANIM SOCIAL

|   | Mënyra e ndihmës                                                              | Nr i familjeve të ndihmuar | Nr i individëve të ndihmuar | Data e fillimit të ndihmës | Data e skadimit të ndihmës | Vlera e qirasë/ndihma financiare (€) mesatarja |
|---|-------------------------------------------------------------------------------|----------------------------|-----------------------------|----------------------------|----------------------------|------------------------------------------------|
| 1 | Banesat e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe donatorët të cilat jepen me qira; | 106                        | 106x5=530                   | 2005                       | N/A                        | 0.30 e m <sup>2</sup>                          |
| 2 | Banesat ekzistuese në pronësi të personave                                    | N/A                        |                             |                            |                            |                                                |

|   |                                                                                                                      |     |  |  |  |  |
|---|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----|--|--|--|--|
|   | fizikë apo juridikë, të cilat mund të jepen me qira për familjet që posedojnë bonus të banimit;                      |     |  |  |  |  |
| 3 | Banesat tjera në pronësi të komunës, që mund të adaptohen për shfrytëzim në bazë të programeve të veçanta për banim; | N/A |  |  |  |  |
| 4 | Shtëpi individuale të ndërtuara nga donatorë të huaj/vullnetarë;                                                     | N/A |  |  |  |  |
| 5 | Renovime/riparime                                                                                                    | N/A |  |  |  |  |

Tabela 6. Familjet momentalisht të ndihmuara me banim social



## KËRKESAT AKTUALE PËR BANIM SOCIAL

Në komunën e Klinës informatat bazike të kategorive në nevojë, për banim social janë si në vijim:

|     |                                     |                 |
|-----|-------------------------------------|-----------------|
| 1.  | Me asistencë sociale nevoja         | 75              |
| 2.  | Kategoritë e dala nga Lufta 1       | 65 Kërkesa      |
| 3.  | Të kthyerit                         | 17 familje      |
| 4.  | Të riatdhesuarit                    | 6 shtëpi banimi |
| 5.  | Të moshuarit                        | 1               |
| 6.  | Të rinjtë                           | 2               |
| 7.  | Të punësuarit nga buxheti shtetëror | 4 Kërkesa       |
| 8.  | Minoritetet                         | 270             |
| 9.  | Tregu i banimit                     | S'ka informata  |
| 10. | Shitja e banesave në treg           | 550E\m2         |
| 11. | Të dhëna me qira                    | 116             |
| 12. | Me qira në kushte të caktuara       | 0               |
| 13. | Pa qira                             | S'ka informata  |

- Me asistencë sociale nevoja: numri i familjeve shfrytëzuese të asistencës sociale për muajin nëntor 2022 është 848 (e dhënë e marrë nga Raporti mujor financiar-ndihma sociale). Ndërsa, kërkesat faktike për përkrahje janë paraqitur si në tabelën e mësipërm:
- Kategori të dala nga lufta: prej vitit 2004 deri në vitin 2018 janë ndarë 106 njesi banesore, ndërsa janë ndërtuar 5 shtëpi, 35 njësive banesore për kategoritë e dala nga lufta janë ndarë në vitin 2018-19.
- Të kthyerit: gjatë viteve 2021-2022, janë 1 familje që kanë paraqitur kërkesa për përkrahje faktike kurse kërkesa për t'u kthyer kanë paraqitur deri më tani 230 persona-familje.
- Të riatdhesuarit: Janë paraqitur 8 kërkesa për zgjidhjen e çështjes së banimit. Vetëm 4 raste të riatdhesuara janë në procedurë për ndërtimin e shtëpisë.
- Minoritetet: nga lista e vitit 2021-2022 janë paraqitur 30 kërkesa për zgjidhjen e çështjes së banimit, ndërsa janë ndërtuar 13 shtëpi;

- Përfitues nga programi OJQ "Voice of Roma, Ashkali and Egyptians" për ndërtim, renovim të shtëpive për vitin 2021 -2022 janë 13 familje ku vlera investime e këtij programi ka kushtuar 30,000.00€
- janë 906 persona të punësuar në sektorin publik dhe rreth 2000 të punësuar në atë privat, shumica prej tyre në qytetin e Klinës (Plani Zhvillimor i Komunës së Klinës).

#### KATEGORITË E SYNUARA

Ndër kategoritë që do të përfitojnë nga programet e banimit parashihen:

- Familjet që nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale;
- Kanë mbetur pa shtëpi si pasojë e dëmtimeve të shtëpive gjatë luftës së fundit;
- Familjet që posedojnë sipërfaqe banimi nën normat e banimit, të përcaktuara për atë kategori sociale dhe ekonomike;
- Kategoritë e dala nga Lufta dhe ish të përndjekurit politikë;
- Të kthyerit dhe komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian (minoritetet);
- Të riatdhesuarit;
- Të moshuarit;
- Të rinjtë;
- Të punësuarit nga buxheti shtetëror;
- Nënata vetushqyese-kryefamiljare;

Kategorizimi dhe specifikimi do të rregullohet sipas bazës ligjore duke i definuar balancën ndërmjet kategorive të synuara nëpër vite të aplikimit sipas të cilit do të përcaktohen kriteret e caktuara për familjet përfituese të cilat do të kenë për bazë: karakteristikat sociale dhe ekonomike të familjeve që presin ndihmën nga autoritetet komunale për të zgjidhur problemet e banimit.

Programe të suksesshme konsiderohen kombinimi i përfituesve nga të gjitha kategoritë duke pasur parasysh edhe përzierjen e kategorive sa i përket moshës - të rinj dhe të moshuar.

#### KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E RADHËS SË PËRPARËSISË

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit kriteret e përparësisë për sigurimin e banimit për kategoritë e cekura në pikën 7.1 janë:



- Statusi i banimit;
- Lartësia e të ardhurave;
- Gjendja shëndetësore;
- Invaliditeti;
- Struktura e familjes;

# GJENDJA FAKTIKE – ANALIZA NË FORMË TABELARE

| KOMUNA E KLINËS                                |                         |                       |                                                |
|------------------------------------------------|-------------------------|-----------------------|------------------------------------------------|
| Nr. I popullsisë                               |                         |                       | 38.200 b.                                      |
| Zonat rurale                                   |                         |                       | 29.500 b.                                      |
| Zonat urbane                                   |                         |                       |                                                |
| Nr. i fshatrave/nr. i lagjeve                  |                         |                       | 8.700 b.                                       |
|                                                |                         |                       | 54 vendbanime                                  |
| Banimi individual                              | Nr. objekteve para 1999 |                       | 6.400                                          |
|                                                | Nr. objekteve pas 1999  |                       | 7.230                                          |
|                                                | Etazhiteti mesatar      |                       | P+2<br><br>18<br><br>280<br><br>28<br><br>1065 |
| Banimi kolektiv                                | Para 1999               | Nr. Objekteve         |                                                |
|                                                |                         | Nj. banimi            |                                                |
|                                                | Pas 1999                | Nr. objekteve         |                                                |
|                                                |                         | Nj. banimi            |                                                |
|                                                | Etazhiteti mesatar      |                       |                                                |
| Statusi pronësor [banim kolektiv) para 1999    |                         | Privat [nj. banimi]   |                                                |
|                                                |                         | Shoqëror [nj. banimi] | 10%                                            |
| Raporti banim individual/banim kolektiv në [%] |                         |                       | 90/10                                          |

|                                                                        |                              |                                                    |
|------------------------------------------------------------------------|------------------------------|----------------------------------------------------|
| Kyçje në infrastrukturë të objekteve të banimit në [%]                 |                              | 80%                                                |
| Nr. i objekteve të pabanuara                                           |                              | /                                                  |
| Nr. i objekteve me vlerë kulturo historike që shfrytëzohen për banim   |                              | /                                                  |
| Aplikimi i masave termo-izoluese në objektet e banimit në [%]          |                              | 70%                                                |
| Ndërtimet ilegale                                                      | Mbindërtimet                 | ska                                                |
|                                                                        | Ndërtimet tjera              | /                                                  |
|                                                                        | Ndërtimet në pronë shoqërore | Skemë informata                                    |
| Numri i kërkesave për zgjidhjen e çështjes së banimit                  |                              | 65                                                 |
| Lokacionet (sipërfaqja e tokës) për programet e veçanta të banimit     |                              | Vend-Asambles                                      |
| Nr. i objekteve/nj. banimi e ndërtuara nga Komuna                      |                              | 9 objekte                                          |
| Qeveria dhe donatorët                                                  |                              |                                                    |
| Nr. i objekteve/nj. banimi me qira dhe vlera mes. e qirasë             |                              | 50-75                                              |
| Nr. i objekteve/nj. banimi të disponueshëm për qira të ulëta të tregut |                              | ska                                                |
| Nr. i objekteve/nj. banimi në pronësi të Komunës që mund të adaptohen  |                              | ska                                                |
| Qendrat e përkohshme kolektive (QPK)                                   | Numri i QPK                  | ska                                                |
|                                                                        | Vendndodhja /emërtimi        | /                                                  |
|                                                                        | Nr. i familjeve              | /                                                  |
|                                                                        | Nr. i banorëve               | /                                                  |
| Planet urbane - sa janë bërë dhe sa janë që duhet të bëhen             |                              | PZHK i –PRRH-<br>Miratuar, si dhe<br>HZ,- Miratuar |



## KLASIFIKIMI I NEVOJAVE SIPAS URGJENCËS SË TRAJTIMIT TË TYRE

Përmes P3B Komuna synon që të ofron banim të qëndrueshëm për personat dhe familjet që nuk kanë fuqi ekonomike të marrin me qira banesë me çmim të tregut. Me këtë nuk pretendohet që brenda afatit prej tri vjetësh t'i plotësoj të gjitha kërkesat, por të veprohet hap pas hapi në mënyrë që me kapacitetet e veta modeste financiare dhe mbështetje eventuale nga niveli qendror, të zgjidhë sa më shumë çështje të banimit. Duke u bazuar në Ligjin në fuqi si dhe në Udhëzimet Administrative, Komisioni Komunal, ka bërë identifikimin e kërkesave të paraqitura për banim dhe duke u bazuar në të, ka dalë me faktin se si kërkesa urgjente për zgjidhje të çështjes së banimit me qira joprofitabile janë **rreth 120 familje**. Mirëpo, për këtë duhet edhe një rishikim dhe konsultim me vendimmarrësit për ndarjen e kësaj të drejtë.

## PLANIFIKIMI KONKRET PËR NDIHMË PËR BANIM SOCIAL

Programi për banim për të gjithë i Komunës së Klinës është hartuar për periudhën 2022-2024. Komisioni i formuar nga ana e **kryetarit të Komunës me ndihmën e OJQ VoRAE**, ka bërë analizë të gjendjes ekzistuese dhe ka përgatitur propozime konkrete për të ndihmuar qytetarët e komunës së Klinës që nuk kanë mundësi të sigurojnë kulm mbi kokë. Përpos ndihmës konkrete për qytetarët e vet, brenda kësaj periudhe tre-vjeçare do të vazhdohet me analiza për të krijuar sektorin e banimit në kuadër të komunës së Klinës, i cili i mungon komunës.

Pra, Programi i prezantuar Tre-Vjeçar për Banim i ka tri objektiva:

Objektiva 1 (O1) Rishqyrtimi i statusit të familjeve të vendosura në ndërtesa për banim social;

Objektiva 2 (O2) Sigurimin e banimit për 36 familje;

Objektiva 3 (O3). Emërimi i një zyrtari për banim;

## 01.RISHQYRTIMI I STATUSIT TË FAMILJEVE TË VENDOSURA NË NDËRTESEA PËR BANIM SOCIAL

Objektiva e parë ka të bëjë me analizën e statusit të familjeve që momentalisht jetojnë në ndërtesa për banim social. Siç është prezantuar në tabelën e mësipërme, për momentin në Klinë në pronësi të komunës janë të ndërtuara 4 ndërtesa me dedikim për banim social të financuara nga MMPS, MMPH dhe donatorë të huaj.

Në këto 4 ndërtesa ekzistojnë 106 njësi banesore të cilat janë të banuara me familje në nevojë për banim social. Meqenëse banimi social ka për qëllim që të vendosen familjet për një periudhë të caktuar kohore (banim i përkohshëm), duhet të bëhet një skanim i të gjitha 106 njërive banesore dhe të analizohet statusi i familjeve që jetojnë në këto banesa.



Duhet që të ftohen të gjitha familjet që nuk kanë kontratë për qëndrim në këto banesa apo të cilëve ju ka skaduar kontrata që të ri aplikojnë. Kjo do të bëhet nga një komision komunal i cili do të menaxhon tërë procesin.

Në këtë mënyrë të gjitha familjet që i plotësojnë kushtet për banim social do të ju mundësohet të vazhdojnë të qëndrojnë në këto banesa duke nënshkruar kontrata me secilën familje. Familjet që nuk i plotësojnë kriteret (pra kanë banim diku tjetër) do të zëvendësohen me familje në gjendje më të rëndë socio-ekonomike.

## **02. SIGURIMI I BANIMIT PËR 36 FAMILJE**

Objektiv tjetër i këtij programi është që në periudhën tre vjeçare komuna e Klinës të jetë në gjendje të ndërtoj edhe 1 objekt banesor me 16 njësi banesore dhe ndihma për 20 familje tjera përmes skemës së bonus banimit. Në periudhë tre vjeçare të ju sigurohet Banim Social 36 familjeve.

Kjo do të bëhet në përputhje të plotë me Ligjin për Financimin e Programeve Tre-Vjeçare për Banim. Sipas këtij ligji, sigurimi i banimit bëhet përmes financimit të programeve të veçanta të banimit me qira, ku përfshihen:

- a) banesat e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe donatorët të cilat jepen me qira;
- b) banesat ekzistuese në pronësi të personave fizikë apo juridikë, të cilat mund të jepen me qira për familjet që posedojnë bonus të banimit;
- c) banesat tjera në pronësi të komunës, që mund të adaptohen për shfrytëzim në bazë të programeve të veçanta për banim.

Banesat e ndërtuara nga Komuna, Qeveria dhe donatorët të cilat jepen me qira;

Nga mbledhjet e zhvilluara me Komisionin Komunal për Hartimin e Planit Trevjeçar të Banimit, *Komisioni ka ardhur në përfundim që do të ndërmerren këto veprime:*

Komisioni është përcaktuar për objektivat vijuese:

### **NDËRTIMI I OBJEKTIT BANESOR PËR DHËNIE ME QIRA JO PROFITABILË**

Një ndër prioritetet kryesore të këtij programi është që në periudhën tre vjeçare, komuna e Klinës të ketë në pronësi të vet edhe një ndërtesë për nevojat e Banimit Social.

Kjo do të bëhet në përputhje të plotë me Ligjin për Financimin e Programeve Trevjeçare për Banim (03/L-164).

Komuna e Klinës i posedon 4 ndërtesa të banimit social, por nevojat në terren sugjerojnë që duhet të ndërtohet edhe një ndërtesë për nevojat e banimit social. Për nevojat e Komunës së Klinës komisioni propozon ndërtimin e **një ndërtese me 16 njësi banesore**. Rreth 10% e



përfituesve duhet të jenë nga komunitetet pakicë sidomos komuniteti Romë, Ashkali dhe egjiptian.

Mesatarja e njësive banesore propozohet të jetë rreth 65 m2 prandaj një kalkulim i përafërt i vlerës për ndërtimin e kësaj ndërtese është si në vijim:

$$65 \text{ m2} \times 16 \text{ njësi banesore} = 1,040 \text{ m2}$$

$$1,040 + 12\% \text{ për hapësirat e përbashkëta} = 1,165 \text{ m2}$$

$$1,165 \text{ m2} \times 260 \text{ €/m2 (vlera e përafërt investive)} = 302,900 \text{ €}$$

Pra vlera e përafërt investive llogaritet të jetë rreth 309,900 Euro

Kjo ndërtesë planifikohet të ndërtohet brenda dy viteve 2023/25.

Për këtë qëllim, komuna e Klinës duhet të ndajë 20% të vlerës investive, pra, rreth 65,200 Euro ndërsa vlera tjetër prej 80 % të kërkohet nga Qeveria e Kosovës.

Në formë tabelore investimi për ndërtimin e ndërtesës për Banim Social duket si në vijim.

| Investitorët:     | Viti 2023    | Viti 2025    |
|-------------------|--------------|--------------|
| Komuna e Klinë    | 32,600 Euro  | 32,600 Euro  |
| Qeveria e Kosovës | 130,400 Euro | 130,400 Euro |
|                   | Totali       | 326,000 Euro |

Aktiviteti 1. PËRCAKTIMI I PARCELAVE PËR NDËRTIM, PRONË KOMUNALE

Veprimet që do të ndërmerren:

- Marrja e vendimit për formimin e Komisionit për Identifikim të Pronave Komunale(KIPK);
- Identifikimi i Parcelave në Pronësi Komunale nga ana (DGJKP);
- Vendimi për ndarjen e Parcelës për Ndërtim.

## Aktiviteti 2. NDËRTIMI I OBJEKTIT PËR BANIM SOCIAL

Veprimet që do të ndërmerren:

- Marrja e Vendimit për ndërtimin e Objektivit P+6;
- Hartimi i (kushteve ndërtimore), kushtet tekniko- urbanistike dhe detyra projektuese;
- Shpallja e tenderit për Hartimin e Projektit të Ndërtimit;
- Përzgjedhja e Projektit për implementim;
- Nënshkrimi i Kontratës mes AK dhe OE;
- Shpallja e Tenderit për ndërtim, si dhe përzgjedhja e OE për zbatim të Projektit dhe nënshkrimi i Kontratës mes AK dhe OE.

Përmes kësaj ndërtese do të ndihmohen 30-35 familje në nevojë për banim të përkohshëm.



## BONUS BANIMI

Për tre vitet në vijim planifikohen që të ndihmohen 20 familje, si më poshtë:

- 5 familje në vitin 2023(buxheti për këto raste duhet të gjendet nga kodi për subvencione apo mallra dhe shërbime, meqenëse buxheti për vitin 2022 është miratuar dhe nuk ka kod të veçantë)
- 15 familje për vitet 2023 dhe 2025. Për këto familje kërkohet që buxheti të jetë i ndarë si nën kod i veçantë.

Kjo formë e ndihmës do të paguhet e tëra nga buxheti Komunal.

Vlera monetare e përafërt e kërkuar për këtë qëllim është si në vijim:

Viti 2023: 15 familje x 50 €/muaj x 12 muaj = 9000 €/vit

Viti 2024: 15 familje x 50 €/muaj x 12 muaj = 9000 €/vit

Viti 2025: 15 familje x 50 €/muaj x 12 muaj = 9000 €/vit

Pra, në total për të ndihmuar 20 familje me bonus banim, nevojiten 27,000 euro

Komuna e Klinës zotohet se nga 20 familje përfituese, rreth 2 familje do të jenë pjesëtarë të komuniteteve pakicë: Serb, Ashkali, Romë dhe Egjiptian.

### Mënyra e implementimit

Për të ndihmuar këto familje, në fillim të vitit komuna e Klinës do të shpall konkurs. Përmes konkursit do të përzgjidhen për t'u ndihmuar 3 deri 5 familje/vit ndërsa për familjet tjera do të ruhen mjetet materiale dhe do të përzgjidhen për rastet ad-hoc (p.sh. dhunë në familje, djegie të shtëpisë, fatkeqësi natyrore, etj). Për këto raste do të vendos komisioni i krijuar për këtë qëllim.

Kontratat do të lëshohen një vjeçare dhe familjet do të duhet të aplikojnë për çdo vit.

### **Banimi individual**

Komuna e Klinës do të vazhdoj komunikimin me donatorë të ndryshëm të cilët janë të interesuar të ndihmojnë familjet të cilat kanë nevojë për banim që të ju ndërtohen/rinovohen shtëpi individuale. Kjo është forma më e qëndrueshme për të siguruar banimin për këto familje.

Komuna e Klinës do të ofrojë informatat relevante dhe do të inicojë programe në këtë drejtim.

## **RIVLERËSIMI I GJENDJES EKONOMIKE TË FAMILJEVE NË PËRPUTHJE ME UA, NR.18/2010 TË LIGJIT NR.03/L-164**

Komuna e Klinës do të bëjë vlerësimin e përfituesve potencial për t'i ndihmuar me banim social por edhe rivlerësimin e familjeve të cilat për momentin ndihmohen nga komuna e Klinës. Veprimet që do të ndërmerren:

- *Formimi i Komisionit për vlerësim;*
- *Rivlerësimi i gjendjes ekonomike të familjeve me qëllim të vazhimit ose ndërprerjes së Kontratës;*
- *Përpilimi i Listës përfituese;*
- *Largimi i familjeve që nuk i plotësojnë kriteret;*
- *Përzgjedhja e familjeve të reja përfituese;*
- *Nënshkrimi i kontratave.*

## **ADMINISTRIMI DHE MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE NË BASHKËPRONËSI**

Veprimet që do të ndërmerren:

- *Zgjedhja e Administratorit*
- *Zgjedhja e Këshillave të banorëve;*
- *Hartimi i Projektit menaxhues;*
- *Nënshkrimi i Kontratës për administrim.*



## IMPLEMENTIMI I PROGRAMIT

Komisioni për përpilimin e këtij programi ka qenë mjaft i kujdesshëm që programi të jetë konkret dhe i zbatueshëm. Programi është konkret dhe i zbatueshëm sepse prezanton numra konkretë të familjeve që planifikohen të ndihmohen brenda tre viteve si dhe është bërë kalkulimi i përafërt i buxhetit të nevojshëm për zbatimin e këtij programi.

Sidoqoftë, komisioni beson se edhe ky program do të mbetet i pazbatueshëm nëse nuk ndërmerren hapa konkretë si në vijim:

### OBJEKTIVI 3 (O3) ÇAKTIMI I ZYRTARIT PËR BANIM

Komuna e Klinës duhet të caktojë një zyrtar i cili në përshkrimin e vendit të punës do të ngarkohet edhe me trajtimin e çështjes së Banimit Social.

Disa nga detyrat e planifikuara të këtij zyrtari propozohen si në vijim:

- Informimi i qytetarëve lidhur me planet komunale për Banim Social;
- Ofrimi i formularëve adekuat për familjet që kanë nevojë të aplikojnë për Banim Social;
- Vendosja e emrave në Data Bazë;
- Krijimi i listës së ngushtë;
- Inicimi i krijimit të komisionit për përzgjedhje të përfituesve;
- Draftimi i kontratave me përfitues;
- Përcjellja e gjendjes së përfituesve;

Ndarja e buxhetit për Banim Social

Ky program rrezikon të mbetet i pazbatuar nëse nuk planifikohet buxhet i caktuar për Banim Social.

Meqenëse ky program është për tre vite, ndarja e buxhetit propozohet si në vijim:

Viti 2023

Për vitin 2023 planifikohet të ndihmohen **15 familje me Bonus Banim** (pagesë të gjysmës së qerasë për familje në nevojë për banim të përkohshëm).

Brenda muajit janar mund të bëhet përzgjedhja e 15 familjeve përfituese të Bonus Banimit prandaj pagesa për Bonus Banim mund të fillon nga muaji Maj 2023.

Për këtë qëllim nevojiten 9,000 Euro. Meqenëse buxheti për vitin 2023 është veçse i planifikuar, propozohet që këto mjete të ndahen nga linja buxhetore për subvencione apo ndonjë linjë tjetër në dispozicion.

Viti 2024

Për vitet në vijim duhet të planifikohet krijimi i një nën-kodi të veçantë buxhetor si pjesë e kodeve për çështje sociale.

Kjo duhet të bëhet në pjesën e parë të vitit 2024.

Për vitin 2024 buxheti i nevojshëm është si në vijim:

Për bonus banim nevojiten 9,000 euro për të ndihmuar 15 familje me Bonus Banim;

Për ndërtimin e ndërtesës për Banim Social gjatë vitit 2024 duhet të ndahen nga komuna e Klinës një vlerë prej 32,600 Euro, ndërsa nga Qeveria e Kosovës përmes MMPHI's do të kërkohen 130, 400 Euro.

Viti 2025

Për vitin 2025 vlera e planifikuar buxhetore do të jetë si në vijim:

për bonus banim planifikohen 9,000 Euro për të ndihmuar 15 familje.

Për përfundimin e ndërtimit të ndërtesës për Banim Social gjatë vitit 2025 duhet të ndahen nga komuna Klinës vlerë prej 32,600 Euro ndërsa nga Qeveria e Kosovës përmes MMPHI's do të kërkohen 130, 400 Euro.

Përmbledhja e nevojave buxhetore në formë tabelar për vit është si në vijim

|                                                     | 2023    | 2024      | 2025      | Totali    |
|-----------------------------------------------------|---------|-----------|-----------|-----------|
| Komuna e Klinës për Bonus Banimi                    | 9,000 € | 9,000 €   | 9,000 €   | 27,000 €  |
| Komuna e Klinës për ndërtimin ne objekteve Sociale  | 0       | 32,600 €  | 32,600 €  | 65,200 €  |
| Qeveria e Kosovës për ndërtimin e objekteve sociale | 0       | 130,400 € | 130,400 € | 260,800 € |
|                                                     |         |           | Totali    | 350,000 € |



## PËRPUTHJA E PROGRAMIT ME PLANET ZHVILLIMORE TË KOMUNËS

Programi trevjeçar i banimit është hartuar në përputhje me ligjet ekzistuese të Republikës së Kosovës. Objektivat e programit janë punuar në atë mënyrë që të jenë në përputhje me Planet rregulluese të hollësishëm të Klinës, gjegjësisht me PRRH.

Me rëndësi për programin është realizimi për 3 vitet e ardhshme, ndërtimi i 1 objektit me rreth 16 njësi banesore, menaxhimi dhe mirëmbajtja e banesave, si dhe mundësia e aplikimit sa më efikas të bonusit të banimit.

## INSTRUMENTE MBIKQYRËSE

Emërimi i një zyrtari për banim i cili do të jetë përgjegjës për koordinimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara, i mundëson fillimisht komunës që të ketë mbikëqyrje direkte në zbatimin e PTB.

Në këtë aspekt, edhe raportimi 6 mujor në Asamblenë komunale mbi të arriturat dhe pengesat në zbatimin e programit mund të konsiderohet si mjet efikas mbikëqyrës. Mirëpo, edhe vetë Ligji e parasheh që MEA të bën mbikëqyrjen e zbatimit të tij përmes inspektorëve urbanistikë.

## INSTRUMENTET E GARANTIMIT TË REALIZIMIT TË PROGRAMEVE

Monitorimi i procesit të zbatimit të programit, vlerësimi i treguesve të suksesit për afatin e paraparë të veprimit si dhe bërja transparente e këtij vlerësimi e garanton realizimin më të efektshëm të programit,

Monitorimi është një mjet i domosdoshëm për sigurimin e vazhdimësisë së zbatimit duke i adresuar dhe përshtatur ndryshimet dhe pengesat në proces, përfshinë këto aktivitete:

- Shkalla e suksesit të Programit në krahasim me Planin e Veprimit,
- Planifikimi i fondeve dhe harmonizimi i tyre në raport me afatet kohore,
- Ndryshimet e mundshme të cilat mund të ndikojnë në realizimin e projekteve (individët, organizatat),
- Ndryshimet e jashtme që mund të ndikojnë në Planin e Veprimit, si dhe propozimet për alternativat e zgjidhjeve të ndikuara nga faktorët tjerë- harmonizimi.
- Bërja publike e raporteve të vlerësimit e bënë edhe më të qëndrueshëm zbatimin e PTB.

## MASAT QË JANË MARRË PËR RESPEKTIMIN E KUADRIT LIGJOR

Pas aprovimit të PTB do të kërkohet nga ministria e Pushtetit lokal vlerësimi nëse programi i prezantuar është në përputhje me ligjet në fuqi për banim.

## PËRFSHIRJA E PUBLIKUT NË PROCESIN E SIGURIMIT TË TRANSPARENCËS

PTB është hartuar për qytetarët e Komunës, andaj përfshirja e tyre që në fazën e hershme të mbledhjes së të dhënave e deri te përcaktimi i objektivave do ta kishin pasuruar programin, si dhe do ta bënin atë më të zbatueshëm. Po ashtu, ky program pas draftimit do t'i nënshtrohet një dëgjimi publik.



## PËRFUNDIM

Nevoja për hartimin dhe zbatimin e efektshëm të Planeve për banim sipas programeve të veçanta kërkon koordinimin e aktiviteteve të të gjithë akterëve në kuadër të komunës, në përputhje me kompetencat e përcaktuara.

Në këtë drejtim është i nevojshëm formimi i Sektorit për banim si organi përgjegjës, që në mënyrë aktive të zhvillojë procesin e zbatimit të aktiviteteve sipas këtij plani. Ndërtimi i njësive të reja të banimit sipas standardeve përmes fondeve nga buxheti komunal, Qeverisë, donatorëve dhe partneriteti publik - privat, që do të sigurojë banimin për grupe të caktuara.

Përmirësimi i kualitetit të banimit, duke pasur parasysh objektet ekzistuese të banimit kolektiv që në një masë sektori i banimit do të ndikojë në ngritjen e vetëdijes dhe motivimin e pronarëve të njësive të banimit si domosdoshmëri e organizimit dhe menaxhimit.

Bazuar në këtë, zhvillimi i banimit orientohet nga:

- Përkrahja në zgjidhjen e çështjes së banimit me banimit me qira joprofitabile ose në bonus të banimit për banesat e tregut me qira të ulët;
- Stimulim i ofertës dhe kërkesës;
- Mbështetje për grupet e rrezikuara për zgjidhjen e problemit të banimit;
- Rritja e ofertës së banesave joprofitabile, zvogëlimin- kufizimin e profitit nga ndërtimet, por jo të rrezikohet interesi i investitorëve që të zhvillojnë aktivitetet ndërtimore të banimit.
- Mirëmbajtja dhe menaxhimi i fondit banesor.

## ANALIZA SËOT

| Përparësitë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | Dobësitë- Mangësitë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ekzistimi i ligjit për programet e veçanta për banim (03/L-164) të përcjellë me shumë Udhëzime Administrative;</li> <li>2. Përpilimi i këtij programi;</li> <li>3. Caktimi i parcelës për ndërtim të një ndërtese për banim social;</li> <li>4. Ekzistimi i Data Bazës për regjistrimin dhe monitorimin e aplikuesve për Banim Social;</li> <li>5. Numri i aplikantëve momental që kanë kërkuar banim;</li> <li>6. Vullneti komunal për trajtimin e temës së Banimit Social;</li> </ol> | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përvoja e pamjaftueshme për banim social;</li> <li>2. Mungesa e ndërtesave në pronësi të komunës që do të mund të përdoret për banim social;</li> <li>3. Buxheti i paplanifikuar për 2023;</li> <li>4. Kosto e lartë e banimit;</li> <li>5. Buxheti i limituar vjetor komunal;</li> </ol>                                                         |
| Mundësitë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | Rreziqet                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Emërimi i një zyrtari për Banim Social;</li> <li>2. Lista e kërkesave;</li> <li>3. Interesimi i Qeverisë së Kosovës për të ndihmuar financiarisht;</li> <li>4. Donatorët tjerë potencial;</li> <li>5. Identifikimi i banesave private që mund të lëshohen për Bonus Banim;</li> <li>6. Programe të përbashkëta me partnerin ndërkombëtar në fushën e banimit;</li> <li>7. Zgjerimi i aktiviteteve përmes skemave të Partneritetit Publiko Privat;</li> </ol>                            | <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Jo stabiliteti politik;</li> <li>2. Rritja e numrit të kërkesave;</li> <li>3. Mosrealizimi i programeve për mungesë të fondeve;</li> <li>4. Niveli i lartë i varfërisë;</li> <li>5. Problemet e vazhdueshme ekonomike dhe financiare;</li> <li>6. Papunësia;</li> <li>7. Trendi i rritjes së numrit të popullsisë;</li> <li>8. Migrimi</li> </ol> |

01nr. 06-41144 /2022  
 Datë: 07-12 /2022



Kryesuesi  
 Fadil Gashi